

NJOFTIM
Nr. 8189, datë 23.11.2020

**PËR PUBLIKIMIN E FTESES PËR OFERTË PËR PROCESIN
KONKURRUES, PËR PËRZGJEDHJEN E OFERTUESIT “PËR ZHVILLIMIN
E PROJEKTIT QË DO TË PËRFITOJË MASAT MBËSHTETËSE PËR
NDËRTIMIN E IMPIANTIT FOTOVOLTAIK NË ZONËN E SPITALLËS”**

Bazuar në vendimin nr. 349, datë 12.6.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe të erës, si dhe të procedurave për përzgjedhjen e projekteve për përfitimin e tyre”, të ndryshuar, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall këtë ftesë për ofertë, për procesin konkurrues për përzgjedhjen e ofertuesit “Për zhvillimin e projektit për ndërtimin e impiantit fotovoltaik, në zonën e Spitallës, Durrës, Shqipëri”.

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
FTESE PËR OFERTË

1. **Emri dhe adresa e autoritetit kontraktues:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë, adresa: rruga “Abdi Toptani”, nr. 1, Tiranë, Shqipëri.

2. **Emri dhe adresa e personave të kontaktit:**

Znj. Jonida Rika, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

E-mail: jonida.rika@infrastruktura.gov.al

Për dijeni: Z. Gjergji Simaku, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

E-mail: gjergji.simaku@infrastruktura.gov.al

3. **Forma, objekti dhe lloji i kontraktimit:** Përzgjedhja e ofertuesit për projektimin, financimin, ndërtimin, funksionimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e një impianti fotovoltaik për gjenerimin e energjisë elektrike, në zonën e Spitallës, qarku Durrës, me një kapacitet të instaluar 100 MWp, nga të cilat 70 MWp si pjesë e masave mbështetëse, dhe me një kapacitet shtesë të instaluar prej 30 MWp, i cili nuk do të jetë pjesë e masave mbështetëse.

4. **Lloji i procesit konkurrues:** Procedurë e hapur.

5. **Vendndodhja e Projektit:** Impianti fotovoltaik do të ketë vendndodhjen në zonën e Spitallës, qarku Durrës, Shqipëri.

6. **Kohëzgjatja e marrëveshjes së zhvillimit të projektit:** 30 vjet (sipas specifikimeve të parashikuara në dokumentet e procesit konkurrues).

7. **Marrëveshja e blerjes së energjisë elektrike:** Si pjesë e masave mbështetëse, marrëveshja për blerjen e energjisë elektrike do të nënshkruhet për kapacitetin 70 MWp, me një afat prej 15 vjetësh.

8. **Afati për dorëzimin e ofertave:** Datë 1 shkurt 2021, ora 16:00, ora e Evropës Qendrore.

9. **Hapja e ofertave:** Datë 8 shkurt 2021, ora 12:00, ora e Evropës Qendrore.

10. **Periudha e vlefshmërisë së ofertës:** Ofertat duhet të jenë të vlefshme për një periudhë 180 ditë nga afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.

11. **Sigurimi i ofertës:** Garancia e ofertës, në shumën prej 400,000.00 eurosh (Katërqind mijë euro), duhet të jetë e vlefshme për një periudhë prej 180 ditësh nga afati për dorëzimin e ofertave.

12. **Blerja e dokumenteve të procesit konkurrues:** Dokumentet e procesit konkurrues mund të blihen duke filluar nga data 19 nëntor 2020, kundrejt pagesës prej 2,000 eurosh (dy mijë euro). Pagesa do të kryhet në llogarinë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Blerja e dokumenteve të procesit konkurrues mund të bëhet me kërkesë edhe nëpërmjet postës elektronike, në pikat e kontaktit, sipas pikës 2 të këtij njoftimi. Pas pagesës, subjekti dërgon kopje të mandatpagesës në MIE ose nëpërmjet postës elektronike.

13. **Dokumentet e tenderit:** Ata që kanë paguar tarifën e pjesëmarrjes, do të kenë të drejtë të marrin dokumentet e tenderit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, pas datës 19 nëntor 2020 çdo ditë pune, nga ora 10:00 deri në orën 14:00 CET. Me anë të kërkesës me postë elektronike, mund të kërkohet dhe kopja elektronike e dokumenteve, pasi të jetë kryer pagesa.

14. **Pranimi dhe vlerësimi i ofertës:** Sipas përcaktimeve në dokumentet e procesit konkurrues.

Informacion shtesë mbi dokumentet e procesit konkurrues mund të gjendet në *website*-in e autoritetit kontraktues: <http://infrastruktura.gov.al>.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Viola Haxhiademi